



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me datës 31 gusht dhe vazhduar me 04 shtator 2023 nëpërmjet kësaj aprovohet si procesverbal i mbledhjes së Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalin e mbledhjes paraprake të mbajtura me datë 31 gusht dhe 04 shtator 2023. Dokumentet aprovohet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-187/2**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-187/3**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe në bazë të Rregullorës Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në AKP-ë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen, kushtet, përshkrimi i pozitës, detyrat dhe përgjegjësit për pozitat sipas strukturës së re organizative: Drejtor Ekzekutiv, Zëvendës Drejtor Ekzekutiv sipas Strukturës së re Organizative dhe Zëvendës Drejtor Ekzekutiv për Funksione operative dhe Funksione të përgjithshme.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin për plotësim ndryshim të Përshkrimit të Punës - Termave të referencës për pozitat e Drejtor Ekzekutiv dhe Zëvendës Drejtor Ekzekutiv sipas Strukturës së re Organizative që dop të hyj në fuqi me datë 01 tetor 2023, si në vijim: 1) Funksione operative dhe 2) Funksione të përgjithshme dhe çështja e shpalljes së konkursit për rekrutimin e tyre.

Bordi i Drejtorëve pas procedurave ligjore ka miratuar Rregulloren 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në AKP. Për të harmonizuar Përshkrimet e vendeve të punës për pozitat e larta drejtuese në AKP të me rregulloren e re kërkohej plotësim ndryshimi i propozuar. Bordi shqyrtoi Termat e Referencës për pozitat e DE dhe ZDE-ve: 1) Funksione operative dhe 2) Funksione të përgjithshme dhe vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Prishtinë, më 28 shtator 2023



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr.5598-11 me sipërfaqe prej 513 m², dhe ngastrës kadastrale nr.5598-13 me sipërfaqe 334 m², ZK Prizren, pronë e NSh PRZ009 "Lavërtaria", në vlerë prej 26,250€ sipas kërkesës së palës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Përfundimtar të Njësisë për Negocim Direkt (NjND), në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e ngastrës kadastrale nr.5598-11 me sipërfaqe prej 513 m², dhe ngastrës kadastrale nr.5598-13 me sipërfaqe 334 m², ZK Prizren, pronë e NSh PRZ009 "Lavërtaria", në vlerë prej 26,250€. Blerësi:

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. NjND ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke përfshirë përcjelljen për pajtueshmëri të palët të vlerësimeve të dorëzuara nga vlerësuesit e pavarur. Në raportet përfundimtare të prezantuara, janë përfshirë elementet qenësore për secilën lëndë, përfshirë raportet e vlerësimit dhe vendimet relevante të Bordit të Drejtorëve lidhur me lëndët në fjalë.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh

Prishtinë, më 28 shtator 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për sipërfaqen tokësore 698 m², pjesë e parcelës Nr. 1252-0, sipërfaqe e përgjithshme 1304 m² Zona Kadastrale Kijevë, Komuna Malishevë, e cila evidentohet në emrin e NSH KB Mirusha, me parashtruesit _____ dhe _____, nga fshati Okjeve, nga fshati Kijevë, Komuna e Malishevës, cilësia e tyre si bashkëpronar me nga 1/3 e pjesës ideale.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njesisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale Nr. 1252-0, sipërfaqe e përgjithshme 1304 m² Zona Kadastrale Kijevë, Komuna Malishevë, e cila evidentohet në emrin e NSH KB Mirusha, me parashtruesit _____ dhe _____ nga fshati Okjeve, nga fshati Kijevë, Komuna e Malishevës, cilësia e tyre si bashkëpronar me nga 1/3 e pjesës ideale. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorie, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas neneve 3.1.2 dhe 3.13 të Rregullores Nr. 06/2022, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale Nr. 57/2, me sipërfaqe prej 4534 m², Zona Kadastrale "Llazarevë" Komuna Obiliq, e cila evidentohet në emrin e NSH KBI "Kosova Eksport"- NSH "Bujqësia" me parashtruesin nga Obiliqi.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njesisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale Nr. 57/2, me sipërfaqe prej 4534 m², Zona Kadastrale "Llazarevë" Komuna Obiliq, e cila evidentohet në emrin e NSH KBI "Kosova Eksport"- NSH "Bujqësia" me parashtruesin nga Obiliqi. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas neneve 3.1.2 dhe 3.13 të Rregullores Nr. 06/2022, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-187/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 mnxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale Nr. 1895/0, me sipërfaqe të përgjithshme 2955 m2, Zona Kadastrale Livagje, Komuna Graçanicë, e cila evidentohet në emrin e NSH KB "Kosova" me parashtruesin,

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale Nr. 1895/0, me sipërfaqe të përgjithshme 2955 m2, Zona Kadastrale Livagje, Komuna Graçanicë, e cila evidentohet në emrin e NSH KB "Kosova" me parashtruesin. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi është i pajtimit se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores duke qenë se përmes pronës së të njëjtës ndërmarrje shoqërore ka qasje në rrugë publike, dhe se nuk ka pëlqimet e fqinjëve, Bordi shqyrtoi propozimin rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-187/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt, për sipërfaqen tokësore 90 m2, nga të cilat 83 m2, janë pjesë e parcelës Nr. 1730-3, kurse 7 m2, janë pjesë e parcelës Nr. 1776-3, Zona Kadastrale Istog, Komuna Istog, të cilat evidentohen në emrin e NSH Radusha, me parashtruesin nga Istogu.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt, për sipërfaqen tokësore 90 m2, nga të cilat 83 m2, janë pjesë e parcelës Nr. 1730-3, kurse 7 m2, janë pjesë e parcelës Nr. 1776-3, Zona Kadastrale Istog, Komuna Istog, të cilat evidentohen në emrin e NSH Radusha, me parashtruesin nga Istogu. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas neneve 3.1.2 dhe 3.13 të Rregullores Nr. 06/2022 Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

ecp.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për sipërfaqen tokësore 104 m2, pjesë e parcelës Nr. 1776-7, me sipërfaqe të përgjithshme 2225, Zona Kadastrale Istog, Komuna Istog (Burim), e cila evidentohet në emrin e NSH Radusha, me parashtruesin nga Istogu.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për sipërfaqen tokësore 104 m2, pjesë e parcelës Nr. 1776-7, me sipërfaqe të përgjithshme 2225, Zona Kadastrale Istog, Komuna Istog (Burim), e cila evidentohet në emrin e NSH Radusha, me parashtruesin nga Istogu. Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas neneve 3.1.2 dhe 3.13 të Rregullores Nr. 06/2022, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/11

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shogërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale nr.02448-3 me sipërfaqe të përgjithshme 458 m², Zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan, e cila evidentohet në emrin e N.SH. "IDGJ" me parashtruesin,
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për parcelën kadastrale nr.02448-3 me sipërfaqe të përgjithshme 458 m², Zona kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan, e cila evidentohet në emrin e N.SH. "IDGJ" me parashtruesin,

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shogërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë dhe duke qenë se rasti plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3.1.2 të Rregullores Nr. 06/2022 Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/12

Në bazë të nenit 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet buxheti shtesë në kategorinë **Kapitale i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin fiskal 2024, në vlerën 40,000 €.**
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për buxhetin shtesë për vitin 2024 pasi që në objektin e ri në të cilin është vendosur AKP-ja është paraqitur nevoja për blerjen dhe instalimin e barrierave optike me krah në hyrjen kryesore të ndërtesës.

Ky projekt ka për qëllim rritjen e sigurisë, kontrollin e hyrje/daljeve për stafin dhe palët e shumta, të cilat vazhdimisht janë sfidë e institucionit tonë, duke ditur numrin e madh të stafit, bashkëpunimin e madh me shumë institucione, si dhe palët e panumërta si rezultat i portfolios së AKP-së, respektivisht menaxhimi me numrin e madh të ndërmarrjeve në likuidim dhe punëtorët e palët e interesit që lidhen me këtë proces.

Bordi shqyrtoi kërkesën për buxhetin shtesë të propozuar nga Menaxhmenti, dhe duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-187/13

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet azhurnimi/harmonizimi i akteve nënligjore në vijim me Rregulloren organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
- II. Aprovohen:
 1. Procedurat e Shitjes me Tender Publik;
 2. Rregullore nr. 06/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit;
 3. Rregullore nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSH-së;
 4. Rregullore nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe
 5. Rregullore nr. 09/2023 për Angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për ndryshimin e pesë (5) akteve nënligjore sipas dispozitivit të këtij vendimi. Me hyrjen në fuqi të strukturës së re organizative dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës u konsiderua e nevojshme që të azhurnohen përkatësisht të harmonizohen dhe të përshtatet terminologjia e përdorur në "Rregullat e Përgjithshme të Tenderit", "Procedurat e Shitjes me Tender Publik", "Rregulloren 04/2022 për qiradhënien e aseteve të NSH-së, Rregulloren nr. 04/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe Rregulloren nr. 06/2020 për Angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore - me strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, për mbarrëvajtje të rregullt të proceseve të cilat janë rregulluar me këto akte nënligjore. Azhurnimet në këto akte nën ligjore janë të natyrës teknike dhe me qëllim të përshtatjes së terminologjisë së përdorur në strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoli 13422/2018 në mes të NSH BQ Drenica” Drenas dhe qiramarrësit Kastriot Ramadanit; nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrime, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për transferim të kontratës së qirasë nga Kastriot Ramadanit tek Visar Ramadanit për asetën e NSH BQ Drenica” Drenas, tokë bujqësore në ZK Zabel i Ulët, në sipërfaqe prej 6HA.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratës së qirasë sipas diapozitivit të këtij vendimi.

Me 29.08.2023 Agjencia ka pranuar shkresën me të cilën kërkojnë që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga Kastriot Ramadanit në Visar Ramadanit pasi që Kastriot Ramadanit ka ndërruar jetë tragjikisht.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Aneks kontrata e qiramarrësit skadon me 30.09.2023.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
eëë.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 15179/2019në mes të NSH BQ Drenica” Drenas dhe qiramarrësit Kujtim Kluna; nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Kërkesa për transferim të kontratës së qirasë nga Kujtim Kluna tek Granit Kluna. për aset in e NSH BQ Drenica” Drenas, tokë bujqësore në ZK Korroticw e Ulët, në sipërfaqe prej 3.5 HA.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për tranfserin e kontratës së qirasë sipas diapozitivit të këtij vendimi.

Me 06.09.2023 Agjencia ka pranuar shpresën me të cilën kërkojnë që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga Kujtim Kluna në Granit Kluna, pasi që qiramarrësi Kujtim Kluna ka ndërruar jetë.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit e pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi nuk ka borxhe, duke mundësuar kështu rritjen ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Aneks kontrata e qiramarrësit skadon me 30.04.2024. Kjo kontratë është rivlerësuar nga Bordi përmes vendimit nr. BD-185/1 të datës 21.08.2023 dhe se vlera e qirasë është pranuar dhe paguar nga i biri i qiramarrësit të ndjerë.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-187/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr.04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e DPT ALBI-G me pronare znj. Lavdiha Kastrati si qiramarrës i lokalit afarist "Supermarketi" në sipërfaqe prej 180 m² pronë e NSh Agrodukagjji - PEJ140 dhe shtyhet afati për pagesë për muajt e faturuar (korrik, gusht dhe shtator 2023) ashtu që obligohet qiramarrësi që për muajt e lartë cekur përveq pagesës së qirasë mujore në shumën prej 350.00 Euro të paguajë edhe borxhin në shumën totale prej 955.00 Euro me tri këste, duke filluar nga janari 2024 deri në mars 2024.
- II. Aprovohet kërkesa për pezullim të kontratës së qirasë për shkak të forcës madhore dhe dëmtimeve që pala ka pësuar si pasojë e vërshimeve në Komunën e Pejës më datë 24 qershor 2023 dhe pezullohet kontrata nga 1 tetori 2023 deri më 31 dhjetor 2023 dhe përgjatë kësaj periudhe pala nuk do të faturohet.
- III. Faturimi në bazë të kontratës së qirasë do të rifillojë nga data 1 janar 2024.
- IV. II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për kontratën e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Sipas vlerësimit të AL-së, pezullimi i Kontratës së Qirasë është i arsyeshëm duke pasur parasysh faktin që pala ka pësuar dëme të jashtëzakonshme si pasojë e një katastrofe natyrore, dhe pezullimi i kontratës së qirasë për afatin prej 01 korrik 2023 deri më 31 dhjetor 2023 do të mundësonte rikuperimin e qiramarrësit dhe biznesit të tij dhe nuk do të paraqiste ngarkim shtesë për palën pasi që pala duhet të kthejë aset në gjendjen e mëmparshme që ka ekzistuar para katastrofës natyrore, do të thotë të investojë në infrastrukturën e asetit dhe në inventarin e brendshëm i cili siç mund të vërehet edhe në bazë të fotove nga terreni ishte i shkatërruar pothuajse tërësisht, si pasojë e atyre vërshimeve. Në shqyrtimin e kërkesës së palës, AL konsideron se duhet merret parasysh edhe fakti që qiramarrësi deri në korrik 2023 ka qenë gjithmonë i rregullt me pagesa dhe asnjëherë nuk ka mbetur borxh, deri sa është paraqitur gjendja e jashtëzakonshme më datë 24.06.2023 dhe kësajohë qiramarrësi ka tanimë borxh muajt korrik, gusht dhe shtator 2023 për të cilat është faturuar. Pala, siç mund të vërehet ka parashtruar kërkesë pranë KK Pejës për kompensim të dëmit të shkaktuar, saktësisht për dëmtim të mallit ka parashtruar kërkesën në vlerën 94,373.77 Euro, ndërsa për dëmtim të inventarizimit, duke përfshirë edhe muret e objektit ka parashtruar kërkesën prej 27,000.00 Euro. Në po këtë kërkesë, ka deklaruar që si pasojë e dëmtimeve nuk është në gjendje të paguajë as qiranë në shumën prej 350.00 Euro AKP-së dhe se ky biznes ka qenë i vetmi burim i të ardhurave për familjen e tyre

M.H.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

nëntë anëtarshë. Ndërsa, duke pasur parasysh edhe dëmtimet që i ka pasur qiramarrësi, investimet që duhen bërë dhe kohën që i duhet për të marrë veten si biznes dhe pasi që objekt i kërkesës është edhe pezullimi i kontratës konsiderojmë që është e arsyeshme që për muajit në vijim (tetor, nëntor dhe dhjetor) palës të i konsiderohet e pezulluar kontrata e qirasë dhe të mos faturohet për këta muaj.

Në këtë situatë vërehet që ka ardhur si pasojë e ndryshimit të rrethanave të cilat qiramarrësi nuk ka mundur të i parandalojë, t'i evitojë apo t'iu shmanget por si shkak i forcës madhore e cila në marrëdhëniet kontraktuale njihet si një ngjarje e cila mund të ndikojë në marrëdhëniet kontraktuale por që janë jashtë kontrollit të palëve.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-187/17

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Farmakos (në likuidim) PRZ026, nga Rajoni i Prizrenit.**
- I. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit NSh Farmakos (në likuidim) PRZ026, nga Rajoni i Prizrenit.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJS, po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të NSh Farmakos (në likuidim) PRZ026, nga Rajoni i Prizrenit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 3, nenit 9.5 dhe nenit 10.3 të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore e amadamentuar me Rregulloren Nr. 02/2023 për Amadamentimin e Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Kontratës së Qirasë me Nr. të protokollit 15781/2017 e dt. 21.02.2017, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet zbritja e qirasë në vlerë të 30% të qirasë mujore, çmimi aktual është në lartësinë prej 4,500.00 euro qiraja mujore për asetin e NSH Auto-Prishtina PRN126 (në Likuidim).
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për kontratën e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.
Kërkesa e Drejtorisë së Policisë së Kosovës konsiston në atë se Policia e Kosovës në bazë të kushteve të krijuara Financiare si shkurtime të buxhetit për Policinë e Kosovës, ka parashtruar kërkesën për zbritje të qirasë. Mandati i AKP-se mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë. Duke pasur parasysh specifikat e asetit dhe qiramarrësit Drejtorisë së Policisë së Kosovës, Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar që një zbritje nga qiraja mujore mund të lejohet e ku as N.S.H. Auto-Prishtina PRN126, nuk do të dëmtohej.
Po ashtu, duke ju referuar edhe nenit 10 par. 3 të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore e amadamentuar me Rregulloren Nr. 02/2023, parashihet që "... në rastet e qirave për institucionet publike, çmimi përfundimtar i qirasë do të miratohet nga Bordi i AKP-së duke marrë parasysh faktor të ndryshëm me arsyeshmëri të interesit publik", zbritja e qirasë do të mund të vlerësohej si e arsyeshme dhe e justifikueshme për arsye se bëhet për njërin nga institucionet më të rëndësishme të sigurisë në vendin tonë. Po ashtu përmes e-mailit personat përgjegjës nga Policia e Kosovës kanë dhënë sqarime se kërkesa e tyre është për zbritjen e qirasë 30% nga qiraja aktuale. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-187/19

Në bazë të nenit 15.1.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe neni 18.1.12 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Rregullorja nr. 10/2023 për organizimin dhe funksionalizimin e Komitetit Drejtues të Likuidimit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektit të likuidimit.
- II. Rregullorja hyn në fuqi me datë 01 tetor 2023.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e Rregullorës nr. 10/2023 për organizimin dhe funksionalizimin e Komitetit Drejtues të Likuidimit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektit të likuidimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në raportin e auditimit të Njesisë për Zbatimin e Projektit të Likuidimit (NJZPL) për vitin 2022 ka rekomanduar që të krijohen procedura dhe udhëzime të shkruara rreth funksionimit të Komitetit Drejtues të Likuidimit (KDL). Andaj, bazuar në të lartëcekurat është hartuar Rregullorja e sipër cekur, dhe e cila ka pritur edhe aprovimin e hyrjes në fuqi të ristrukturimit. Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023



Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-187/20

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Udhëzuesit mbi procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme i datës 30 dhjetor 2014, Kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim K.K. Istog për Kryetarin e Komunës së Istogut në lidhje shpalljen si zonë me interes të përgjithshëm parcelën kadastrale nr.01776-2 (ku shtrihet pompa e benzinës) me referencën 04 nr.105/2020 dt.12.11.2020, Vendimit të Kuvendit Komunal të Istogut me referencë 01 Nr.79/2020/2021 dt.04.12.2020 Për Shpalljen "Interes të Përgjithshëm" parcelën kadastrale me nr.01776-2, Vendimit të Kuvendit Komunal të Istogut me referencë 01 Nr.24/2021 dt.04.03.2021 për Plotësimin Ndryshimin e Vendimit 01 Nr.79/2020 Për Shpalljen Interes të Përgjithshëm parcelën kadastrale me nr.01776-2, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 28 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për shlyerjen e borxhit për ish qiramarrësin "IBOS" Sh.p.k. për shkak të pamundësisë së ushtrimit të veprimtarisë afariste nga ana e qiramarrësit. Shlyerja e borxhit aprovohet në masë 50% të vlerës prej 52,100.00 € të borxhit total për shkak të pamundësisë së ushtrimit të veprimtarisë afariste nga ana e qiramarrësit, respektivisht në shumë prej 26,050.00€
- II. Obligohet qiramarrësi "IBOS" Sh.P.K që të paguajë borxhin e mbetur në shumën prej 11,998.98 €.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për kontratën e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi që është në agjendë qysh nga mbledhja e 29 mars 2023.

Bordi shqyrtoi materialin e prezentuar nga AL-ja me të cilin ndër të tjera njoftuan se me dt.30.09.2020 qiramarrësi IBOS ka njoftuar AKP-Zyrën Rajonale të Prishtinës në lidhje me pompën që e shfrytëzon me qira pronë e INA Trgovina Zagreb, e cila gjendet ne Istog dhe e cila aktualisht nuk mundet të përdoret, për arsye se Komuna është duke ndërtuar një rreth rrotullim dhe është duke e zgjeruar rrugën kështu që pjesa ku gjendet pompa e karburanteve nuk mund të përdoret, pra, nuk mundet të zhvillohet aktiviteti për te cilin është dhënë me qira (shitja e karburanteve). Për këtë arsye qiramarrësi ka kërkuar që mos të faturohet koha deri sa të zgjatin këto punime të rregullimit të rreth rrotullimit dhe rrugës.

Qiramarrësi i lartcekur përsëri e ka njoftuar AKP-në me dt. 23.02.2021 se pompa e benzinës në Istog është jashtë funksionit për arsye të zgjerimit të rrugës, këtij njoftimi iu janë bashkangjitur edhe fotot, si dhe ka kërkuar që mos të faturohet si dhe dëshiron ta shkëpus kontratën e qirasë për arsyet e lartcekura.

Njoftimi i dt.23.02.2021 i qiramarrësit mbi ndërtimin e rreth rrotullimit dhe zgjerimin e rrugës mbështet edhe nga Vendimet Komunale.

Gjatë vizitës në teren të pompës së benzinës në Istog, zyrtari i rastit ka konstatuar se qasja në pompë është vështirësuar tej mase dhe nuk mund të zhvillohet aktiviteti normal i shitjes se derivateve të naftës.

Një kërkesë e tillë i ishte paraqitur Bordit të Drejtorëve të AKP-së edhe në mbledhjen e datës 29 prill 2022, ku Bordi kishte kërkuar që qiramarrësi t'i dëshmojë Agjencisë shkallën e dëmit financiar të pretenduar me dokumente të besueshme siç janë të hyrat nga dogana për pompën në fjalë, deklaratën tatimore nga ATK, qarkullimin vjetor apo dokumente tjera të ngjashme të cilat saktësojnë dëmin e pretenduar financiar nga pala gjatë periudhës në fjalë.

MLH.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Dokumentet e dorëzuara nga qiramarrësi si Librat e shitjes, sipas kërkesës së Brordit janë verifikuar nga AL-ja përmes shkresës së siguruar nga ana e ATK-së, kur ndër të tjera kanë njoftuar se nuk lëshojnë libër të shitjes por bizneseve ju ofrohet formati unik për deklarime të librit të shitjes përmes sistemit elektronik EDI. Po ashtu sipas AL-së, ATK-ja ka konfirmuar se sipas pajisjes fiskale me nr. EN13000564 kanë konstatuar se librat e shitjes të përcjellura tek AL-ja (të siguruar nga qiramarrësi) janë të njëjtat me shitjet e bëra nga pajisja fiskale në atë njësi.

Megjithatë këtyre fakteve Bordi është i pajtimit që falja e borxhit është e drejtë në masë 50% të vlerës prej 52,100.00 € të borxhit total për shkak të pamundësisë së ushtrimit të veprimtarisë afariste nga ana e qiramarrësit, respektivisht në shumë prej 26,050.00€

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 28 shtator 2023.



Mentor Hyseni
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit